



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GJILANE/MUNICIPAL GILAN/GILAN BELEDIYESI



NJËSIA E KUVENDIT/SKUPSTINSKA JEDINICA/MUNICIPAL ASSEMBLY UNIT

Datë	19.09.2023
Për	Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes	Sadri Arifi, Udhëheqës i Njësisë së Kuvendit
Nga	z.Kushtrim Kadriu, Kryesuesi i KK Gjiçan
Lënda	Lista e akteve të KK Gjiçan




Bashkangjitur po ju përcjellim tabelën e akteve si dhe numrin e votave që kanë marrë në mbledhjen e Jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit të mbajtur më 18.09.2023

Nr	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1	Vendim për shpalljen e interesit të ligjshëm publik	17	0	14	01.Nr.016-98769/23



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të LVL-së, me qëllim të sigurimit të tokës për zbatimin e kompetencave të plota dhe ekskluzive të komunës të parapara me nenin 17, pika (b) dhe (f) të Ligjit nr.03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale dhe me dispozitat e Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, në seancën e mbajtur me datë 18.09.2023, miraton këtë :

V E N D I M Për Shpalljen e Interesit të Ligjshëm Publik

1.Kuvendi i Komunës Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës, 02.nr.874 të datës 23.06.2023 për Shpalljen e Interesit të Ligjshëm Publik për sigurimin e tokës për hapjen e "Varrezave të Reja të Qytetit" në ZK Shillovë.

2. Interesi i Ligjshëm Publik shpallet në këto njësi kadastrale:

2.1. Njësinë kadastrale: P-70403064-01006-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona rurale, sipërfaqja 6545 m², vendi i quajtur "Sekireshe", tokë jopjellore, pronar: D.S.OOUR Shumsko Gazdinstvo (P.Sh. Organizata Bazë e Punës së Bashkuar Ekonomia e Pyjeve Gjiçan), pjesa e pronës 1/1, Zona Kadastrale Shillovë.

2.2. Njësinë kadastrale: P-70403064-01007-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona rurale, sipërfaqja 60039 m², vendi i quajtur "Sekireshe", kullosë e klasit 5, pronar: D.S.OOUR Shumsko Gazdinstvo (P.Sh. Organizata Bazë e Punës së Bashkuar Ekonomia e Pyjeve Gjiçan), pjesa e pronës 1/1, Zona Kadastrale Shillovë.

2.3. Njësinë kadastrale: P-70403064-01009-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona rurale, sipërfaqja 125704 m², vendi i quajtur "Garevina", kullosë e klasit 5 dhe kullosë e klasit 4, pronar: D.S.OOUR Shumsko Gazdinstvo (P.Sh. Organizata Bazë e Punës së Bashkuar Ekonomia e Pyjeve Gjiçan), pjesa e pronës 1/1, Zona Kadastrale Shillovë.

2.2. Njësinë kadastrale: P-70403064-01802-0, lloji i njësisë: parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, zona rurale, sipërfaqja 13387 m², vendi i quajtur "Sekireshe", kullosë e klasit 5, pronar: D.S.OOUR Shumsko Gazdinstvo (P.Sh. Organizata Bazë e Punës së Bashkuar Ekonomia e Pyjeve Gjiçan), pjesa e pronës 1/1, Zona Kadastrale Shillovë.

3. Ngastrat kadastrale të propozuara nevojiten për sigurimin e tokës me qëllim të ushtrimit dhe realizimit të kompetencave të plota dhe ekskluzive të komunës të parapara me nenin 17, pika (b) dhe (f) të LVL-së (Ligji nr.03/L-040), në sferën e planifikimit urban dhe rural si dhe ofrimin, mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe komunale.


4. Pas miratimit të Vendimit të Kuvendit Komunal për Shpalljen e Interesit Publik, Kryetari i Komunës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi (Ligjit për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Ligjit për AKP-në etj.) do t'i drejtohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Bordit të AKP-së për procedurat e parapara ligjore për bartjen e kësaj prone në pronësi të komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr.016-98769/23

Gjilan, më 18.09.2023



Kuvendi i Komunës

/Kushtrim Kadriu/

Kryesues i Kuvendit